

Refik Halili: I garantoj tifozet e Tiranës se do të kapim Kupat e Europës

nga AlbaniaSoccer

E diel, 17 Nëntor 2013 22:53



Kriza e Tiranës ka një zgjidhje. Ish presidenti Refik Halili tani si një sponsor për bardheblutë ka premtuar për tifozet një zgjidhje të shpejtë. “Tirana nuk vdes kurrë. I premtoj tifozëve që shumë shpejt do të ndërtojmë një skuadër konkurruese dhe ne nuk do të zbrisim nga kategoria. Përkundrazi, do të bëjmë mirë dhe do ta arrisim vendet e larta në tabelën e klasifikimit për të synuar Kupat e Europës. Diferencat në kampionat janë të vogla dhe na duhen disa lojtare në merkaton e janarit për të arritur aty ku duhet. Bisedimet i kemi nisur”, ka deklaruar Refik Halili.